

# Statistikat e Kulturës

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	5
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	9
19. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Albana Berbiu
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:aberbiu@instat.gov.al">aberbiu@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	22.06.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	22.06.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	22.06.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e kulturës përmbajnë të dhëna statistikore lidhur me aktivitetet kulturore të teatrove, muzeve, bibliotekave, baletit, ansamblit, qendrës kulturore të fëmijëve si dhe përmban të dhëna për numrin e shfaqjeve dhe vizitorëve në këto institucione arti dhe institucione të trashëgimisë kulturore.</p> <p>Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore të cilat janë në varësi nga Ministria e Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirku Kombëtar.</p> <p>Përveç treguesve që lidhen me pjesëmarrjen dhe trashëgiminë kulturore, statistikat e kulturës përfshijnë edhe arsimin dhe punësimin në kulturë, përdorimin e internetit për qëllime kulturore, indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore si dhe Shpenzimet Publike</p>

	për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare.
3.2. Sistemi i klasifikimit	NACE Rev.2 dhe ISCO-08 për punësimin në kulturë. ISCED-F 2013 për arsimin në kulturë. Klasifikimi Evropian i Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP).
3.3. Mbulimi i sektorit	Treguesit kryesorë që janë mbuluar nga moduli statistikat e kulturës. <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Numri i shfaqjeve, premierave, spektatorëve në institucionet qendrore të artit;</li> <li>2. Numri i botimeve mbështetur nga Ministria e Kulturës;</li> <li>3. Numri i faqeve të digjitalizuara, frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare;</li> <li>4. Numri i vizitorëve në parqe arkeologjike;</li> <li>5. Numri i vizitorëve në muzetë kombëtarë, në kalatë që administrohen nga Ministria e Kulturës;</li> <li>6. Numri i monumenteve të futura në zona mbrojtëse, të vendosura në mbrojtje paraprake;</li> <li>7. Studentë të regjistruar në arsimin e lartë në fushat e studimit të lidhura me kulturën.</li> <li>8. Përqindja e studentëve të regjistruar në fushat e kulturës sipas gjinisë.</li> <li>9. Punësimi në kulturë sipas gjinisë.</li> <li>10. Përqindja e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin në kulturë dhe në punësimin gjithsej.</li> <li>11. Shpërndarja e punësimit gjithsej dhe punësimit në kulturë sipas nivelit arsimor,</li> <li>12. Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas gjinisë.</li> <li>13. Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grupmoshës.</li> <li>14. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore.</li> <li>15. Ndryshimi vjetor në përqindje të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore.</li> <li>16. Shpenzimet publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare.</li> </ol>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b><u>Përkufizime</u></b></p> <p><b>Trashëgimi kulturore</b> është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçarur brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.</p> <p><b>Muze</b> është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.</p> <p><b>Monument kulture</b> është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.</p> <p><b>Park arkeologjik</b> është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente</p>

	<p>të një muzeu në natyrë.</p> <p><b>Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve</b> për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.</p> <p><b>Bibliotekat</b> janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.</p> <p><b>Frekuentimi</b> llogaritet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.</p> <p><b>Materiale bibliotekare</b> përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.</p> <p><b>Tituj të rinj</b> përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyjnë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.</p> <p><b>Ekzemplarë të rinj</b> përfshijnë numrin e njësisve bibliotekare për çdo titull të ri.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e të dhënave është shfaqja kulturore, spektatorët, vizitorët.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet: numrit të shfaqjeve, aktiviteteve kulturore dhe vizitorëve në institucionet e artit dhe kulturës dhe në institucionet e trashëgimisë kulturore.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e statistikave të kulturës mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e statistikave të kulturës datojnë prej vitit 2017 dhe në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Numri gjithsej i shfaqjeve kulturore, Numri gjithsej i spektatorëve, Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje, Numri i vizitorëve gjithsej në muze, kala dhe parqe arkeologjike, Numri i frekuentuesve në bibliotekë.
5. Periudha e referencës	Periudha referuese e informacionit statistikor mbi statistikat e kulturës deri në vitin 2020 ka qënë tremujore ndërsa nga viti 2021 është vjetore. Ky raport i referohet vitit 2022.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për prodhimin e treguesve mbi Statistikat e kulturës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026</a></li> <li>• Memorandum me Ministrinë e Kulturës.</li> </ul>

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Nuk aplikohet. INSTAT nuk transmeton të dhëna mbi statistikat e kulturës në Eurostat.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijojnë paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.

8.2. Akses i në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendari i Publikimeve</a> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqeweb – publikim në internet;</li> <li>• Kërkesat e shkruara;</li> <li>• Publikimet e Statistikave të Kulturës;</li> <li>• <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ul>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikat e Kulturës deri në vitin 2020 janë publikuar në periudha kohore me bazë tremujore. Duke filluar nga viti 2021 statistikave të kulturës publikohen me frekuencë vjetore.
<b>10. Akses i në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë për kulturën. Njoftimi për shtyp i Kulturës publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	<p>Rezultatet për Statistikat e Kulturës gjenden të botuara në botimin: “<a href="#">Kultura</a>”; “<a href="#">Shqipëria në Shifra</a>”.</p> <p>Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Këtu mund të aksesohet <a href="#">databaza</a> statistikore mbi statistikave të kulturës.
10.4. Akses i në të dhënat mikro	Nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike për Statistikat e Kulturës nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kërkesë të dhënash</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe <a href="#">metodologjisë</a> për statistikave të kulturës i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si dhe në temën Kultura. Informacione të tjera shtesë ju ofrohen përdoruesve të brendshëm nëse kërkohen.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale dokumenton të gjithë proceset dhe procedurat e punës për përdorim të brendshëm.

<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Burimi kryesor i të dhënave për Statistikat e Kulturës është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash. Burim tjetër të dhënash mbi Kulturën janë edhe vrojtimet me zgjedhje që kryhen nga INSTAT.</p>
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave të kulturës klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdoruesit e jashtëm janë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucionet e Administratës Publike;</li> <li>2. Universitetet;</li> <li>3. Bizneset;</li> <li>4. Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit;</li> <li>5. Organizata kombëtare jofitimprurëse;</li> <li>6. Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat</li> </ol> </li> <li>• Përdoruesit e brendshëm janë brenda INSTAT të cilët përdorin Statistikat e kulturës si input për punën e tyre.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me “Statistikat e Kulturës” për vitin 2022 janë rreth 1,932 klikime.</p> <p>Gjatë 2022, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Kulturës është vlerësuar me 3.44 (68.8%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë se Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave mbi “Statistikat e Kulturës” për vitin 2022 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026). Shkalla e</p>

	Plotshmërisë në lidhje me “Statistikat e Kulturës”, për 2022 është 100%.								
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mbi “Statistikat e Kulturës” grumbullohet nga burimet administrative, dhe të dhënat janë finale. Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Statistikave të Kulturës” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 173 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 173 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Kulturës është 31 Dhjetori 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/22/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>173</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	6/22/2023	Afatet kohore	173		
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e publikimit	6/22/2023								
Afatet kohore	173								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Statistikave të Kulturës publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të Kulturës ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>6/22/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>6/22/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	6/22/2023	Data e publikimit	6/22/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	6/22/2023								
Data e publikimit	6/22/2023								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat e Kulturës paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.								



15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat e Kulturës datojnë që nga viti 2017 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 6 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=6).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave kontrollohet me rregullat e validimit të shumës, si shuma e nëntotalit, ndryshimet e mëdha ndër vite, ndryshime të mëdha, siç përmendet në raport.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Kulturës pranë sektorit të Zhvillimit të Statistikave Sociale është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se institucionet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi “Statistikat e Kulturës” raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikat e Kulturës” për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Ofruesit kryesorë të të dhënave që bazohen në burime administrative janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Ministria e Kulturës</li> <li>○ Ministria e Arsimit dhe Sportit</li> <li>○ Ministria e Financave dhe Ekonomisë</li> </ul> <p>Vrojtimet Statistikore kryesore që sigurojnë informacionin nga anketimet janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Anketa e Forcave të Punës, INSTAT</li> <li>○ Anketa e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, INSTAT</li> <li>○ Anketa e Çmimeve të Konsumit, INSTAT</li> </ul>

18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo tremujor.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të kulturës, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikave. Ministria e Kulturës është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi. Të dhënat nga Vrojtimet e INSTAT sigurohen nga sektorët përkatës brenda institucionit.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave iu bëhen kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komente</b>	
<b>Aneks</b>	